

VENDIM
Nr. 286, datë 2.4.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 511, DATË 24.10.2002, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË
INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 40, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 76-108, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e kreut II/A, “Puna në ditët e festave zyrtare dhe të pushimit javor”, të vendimit nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kur festa zyrtare bie në ditët e pushimit javor, dita e hënë është ditë pushimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama